

**VENDIM**  
**Nr. 655, datë 14.9.2016**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE”, BASHKIA KORÇË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave publike”, Bashkia Korçë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Korçë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë “tokë arë”, me sipërfaqe 13 380 (trembëdhjetë mijë e treqind e tetëdhjetë) m<sup>2</sup>, me vlerë të përgjithshme prej 1 338 044 (një milion e treqind e tridhjetë e tetë mijë e dyzet e katër) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 338 044 (një milion e treqind e tridhjetë e tetë mijë e dyzet e katër) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Korçë, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Korçë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë Korçë të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 13 380 (trembëdhjetë mijë e treqind e tetëdhjetë) m<sup>2</sup> “tokë arë”, për projektin “Zgjerim i varrezave publike”, të bëhet në favor të Bashkisë Korçë.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së tokës në Këshillin e Qarkut Korçë dhe Bashkia Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**Niko Peleshi**

**LISTA E PRONAVE DHE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR SHKAK TË “ZGJERIMIT TË VARREZAVE PUBLIKE”, NË BASHKINË E KORÇËS**

| Nr. rendor | Emër      | Atësia  | Mbiemër  | Nr. pasurie | Faq. | Lloji i pas. | Truall. (m <sup>2</sup> ) ZVRPP | Truall (m <sup>2</sup> ) i pjesshëm | Sip. e cila shpron. | Çmimi lekë/ m <sup>2</sup> | Vlera e shpronësimit | Shënime                 |
|------------|-----------|---------|----------|-------------|------|--------------|---------------------------------|-------------------------------------|---------------------|----------------------------|----------------------|-------------------------|
| 1          | Izet      | Bekdash | Armata   | 183/1       | 232  | arë          | 940                             | 871                                 | 871                 | 100                        | 87,100               | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 2          | Vasil     | Petraq  | Tarusha  | 183/2       | 233  | arë          | 2630                            | 347                                 | 347.000             | 100                        | 34,700               | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 3          | Flamur    | Sabri   | Braholli | 188/1       | 19   | arë          | 3180                            |                                     | 1578.600            | 100                        | 157,860              | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 4          | Nikolla   | Kristo  | Kapurani | 182/1       | 212  | arë          | 2070                            | 1811                                | 1810.630            | 100                        | 181,063              | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 5          | Piro      | Petro   | Kaçe     | 182/8       | 166  | arë          | 933,34                          | 26                                  | 26.000              | 100                        | 2,600                | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 6          | Thodhoraq | Pandi   | Zguri    | 182/6       | 217  | arë          | 1630                            | 231                                 | 230.601             | 100                        | 23,060               | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 7          | Fidane    |         | Potka    | 162/4       | 212  | arë          | 4480                            | 332                                 | 332.040             | 100                        | 33,204               | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 8          | Ropi      | Jorgji  | Sejmeni  | 162/5       | 213  | arë          | 2440                            | 364                                 | 363.630             | 100                        | 36,363               | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 9          | Gjergji   | Shaban  | Haxhi    | 162/6       | 214  | arë          | 3500                            | 668                                 | 667.770             | 100                        | 66,777               | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |

|    |               |       |          |        |     |     |         |      |               |     |                  |                         |
|----|---------------|-------|----------|--------|-----|-----|---------|------|---------------|-----|------------------|-------------------------|
| 10 | Gentian       | Refik | Musli    | 162/7  | 215 | arë | 2700    | 964  | 963.660       | 100 | 96,366           | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 11 | Kostanca      | Piro  | Kaçe     | 182/7  | 165 | arë | 1866.66 |      | 1335.000      | 100 | 133,500          | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 12 | Izet          |       | Armata   | 162/1  | 209 | arë | 3 980   | 266  | 266.000       | 100 | 26,600           | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 13 | Gjergji       | Ylli  | Vença    | 162/9  | 217 | arë | 1 9 550 | 124  | 124.000       | 100 | 12,400           | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 14 | Gentian       | Elmaz | Duçi     | 162/3  | 211 | arë | 6 300   | 236  | 236.000       | 100 | 23,600           | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 15 | Ismail        | Ali   | Osmani   | 162/33 | 109 | arë | 5 330   | 371  | 371.000       | 100 | 37,100           | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 16 | Donika        |       | Tanasica | 184/38 | 9   | arë | 1000    | 1000 | 1000.000      | 100 | 100,000          |                         |
| 17 | Dhimitraq     |       | Gorica   | 188/22 | 239 | arë | 800     | 636  | 636.000       | 100 | 63,600           | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 18 | Andrea        |       | Gorica   | 188/23 | 240 | arë | 800     | 486  | 485.510       | 100 | 48,551           | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 19 | Pirro         |       | Gorica   | 188/24 | 241 | arë | 800     | 86   | 86.000        | 100 | 8,600            | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 20 | Theodhoraq    |       | Zguri    | 182/9  | 113 | arë | 2000    | 1500 | 1500.000      | 100 | 150,000          | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 21 | Pandi         |       | Kote     | 182/10 | 114 | arë | 460     | 150  | 150.000       | 100 | 15,000           | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
|    | <b>TOTALI</b> |       |          |        |     |     |         |      | <b>13,380</b> |     | <b>1.338.044</b> |                         |